

MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS NDËRTIMI I BAZËS SË MONUMENTIT "NEW BORN"



Kontrata e parë për "Ndërtimin e bazës së monumentit "New Born" ishte dhënë më 3.3.2019 operatorit ekonomik "Migrant Ing" me vlerë 14,347 €.

Tenderë me procedurë të hapur. Kanë aplikuar 9 ofertues.



Komuna e Prishtinës nuk i'u është përgjigjur kërkesës për qasje në dokumentat e kontratës së parë.



Kontrata e parë ishte e publikuar në ueb-faqe të Komunës së Prishtinës, mirëpo nuk ishte në ueb-faqen e "E-Prokurimit".



Komuna e Prishtinës nuk ka publikuar ndonjë njoftim për ndërprerjen e kontratës së parë.


Fakti që në ueb-faqe të Komunës kanë qenë dy kontrata të publikuara për të njëjtin aktivitet ka shkaktuar huti se cila prej tyre është realizuar.




Meqë kontrata e parë nuk ishte zbatuar, Komuna e Prishtinës e ka kontraktuar një operatorë tjetër për të realizuar këtë projekt të nevojshëm.

Kontrata e dytë për "Ndërtimin e bazës së monumentit "New Born" ishte dhënë më 23.12.2019 operatorit ekonomik "Izolimi" me vlerë 22,245 €.

Tenderë me procedurë të hapur. Ka aplikuar 1 ofertues.



Më 24.02.2020 ka qenë data e fillimit të ndërtimit dhe afati i kryerjes ka qenë 45 ditë, mirëpo deri me datën 17 gusht baza nuk është përfunduar.



Komuna e Prishtinës nuk ka treguar arsyet e zvarritjes së punimeve, mirëpo është e qartë që bazuar në plani fillestar për përfundim të punimeve, që figuron në tabelen e vendosur tek monumenti, nuk është zbatuar.



Komuna e Prishtinës nuk ka qenë transparente pasi nuk ka ofruar dokumentet dhe sqarimet e nevojshme për kontratën e parë: nuk ka treguar nëse është shkëputur kontrata e parë, nëse operatorie ekonomik i janë bërë pagesa, punët që janë kryer me kontratën e parë apo nëse është penalizuar operatori ekonomik me të cilën është nënshkruar kontrata.



REKOMANDIME

Komuna e Prishtinës të publikoj në web-faqe dhe E-Prokurimi arsyen e ndërprerjes së kontratës së parë.

Komuna e Prishtinës të jetë transparente duke ofruar informacione dhe dokumentacionin e kërkuar në mënyrë që të parandalojë shpërndarjen e lajmeve gjysmake.